



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 469/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Fushë Kosovë, paraqitur kundër një aktivistit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), dega në Fushë Kosovë për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Fushë Kosovë.

### **Arsyetim**

Me datën 04.11.2013, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se me datë 03.11.2013 në ora 16:20 në fshatin Bardh i madh, në vendvotimin tek shkolla "Zenel Salihu" erdhi djali i Nefi Krasniqit po nga i njëjti fshatë, ai erdhi me automjetin e tij në të cilin kishte flamurin e LDK-së, dhe fotografinë e kandidatit për kryetar të komunës nga LDK-ja Burim Berisha duke shkelur ligjin Nr.03/L-073, si dhe nenin 36.b) në këtë rastë thuhet në ankesë se rasti është konfirmuar nga policet në vendvotim.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet e parashtruesit të ankesës nuk qëndrojnë, ngase parashtruesi i ankesës, nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për parregullsinë e pretenduar. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 469/2013 më datën 06.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**



***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*